

VENDIM
Nr. 27, datë 14.02.2022

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES
SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA TË
RINOVUESHME NGA DIELLI, ERA DHE NGA PJESA E BIODEGRADUESHME E
MBETJEVE TË NGURTA QË SHFRYTËZOJNË MBETURINAT INDUSTRIALE,
URBANE DHE RURALE PËR VITIN 2022**

Në mbështetje të nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”; VKM-së nr. 27, datë 17.1.2018, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale” dhe rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 14.2.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 236/4 prot., datë 11.2.2022, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2022”,

konstatoi se:

- VKM nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, në pikën 2 të saj, ngarkon ERE-n me detyrimin për miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar për vitin 2017, sipas parashikimeve të kësaj metodologjie, bazuar në referencat e tabelës së paraqitur në këtë VKM për sa i takon LCOE dhe WACC ose të dhënave konkrete të kostove të investimeve që mund të sigurohen për vitet në vijim.

- VKM nr. 27, datë 17.1.2018, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale”, përcakton, ndër të tjera, se për investimet për të cilat subjektet janë pajisur me autorizimin përkatës pas datës 1 janar 2018 e në vijim, ERE do të miratojë çmimin në bazë të të dhënave të grumbulluara, për sa i përket kostove reale të investimit, nëse rezultojnë të ndryshme nga parashikimet e kësaj metodologjie.

- Metodologjia e miratuar me VKM-në nr. 369, datë 26.4.2017, përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve, sipas llojit të teknologjisë së përdorur.

- Ndërkohë, metodologjia e miratuar me VKM-në nr. 27, datë 17.1.2018, përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit që duhet të paguhet për një njësi output si pagesë për fuqinë e prodhuar, me qëllim që të arrihet një rikthim financiar i caktuar – ose të vendoset thjesht çmimi që projekti duhet të fitojë për mwh, me qëllim që të arrihet *break-even* ose të ardhurat të barazojnë kostot e prodhimit.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka lëshuar: 1) autorizimin paraprak; 2) miratimin përfundimtar për ndërtimin e veprave për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të vogla të

rinovueshme nga dielli dhe era; si dhe gjeneratorët e vegjël me burim të rinovueshëm nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale.

- Ky informacion do të shërbejë për vlerësimin dhe shqyrtimin e të dhënave të nevojshme për llogaritjen e çmimeve për teknologjitë në fjalë, mbështetur në përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2022.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti